

PROBLEME DHE DISKUTIME

HAJRI SHEHU

PËR KULTURËN LEKSIKORE

Kultura leksikore vjen nga metagjuha leksikore. Metagjuha leksikore është tërësia e termave të leksikologjisë dhe të leksikografisë (le të themi, *leksik, frazeologji* etj.). Janë terma të pranuar, që vijnë me koncepte të pranuar. Dhe konceptet e pranuar vijnë me përkufizime të pranuar.¹ Por a ndodh që të ketë në ndonjë shkrim leksikologjik a leksikografik ndonjë përdorim (termi), që nuk na çon tek termi i duhur e te koncepti i pranuar?

Kemi lexuar në një shkrim thënien **gjuhë krahinore**. A ka gjuhë krahinore? Nuk ka gjuhë krahinore. Ka të folme krahinore. Një shpjegim i vogël: Gjuha standarde është një sistem që hyn në një sistem më të gjerë – në gjuhën kombëtare. Për nga pasuria e funksionet shoqërore, në krahasim me të folmet krahinore, gjuha standarde është e ndryshme. Edhe për nga sistemorësia. Gjuha standarde formon një sistem të vetëm. Të folmet krahinore nuk formojnë sistem më vete. Ai (sistemi) është shumë e sistemeve krahinore. Por të gjitha të folmet i bashkon baza e përbashkët popullore.² Kjo e bën gjuhën e përgjithshme (brenda saj, edhe gjuhën standarde) mjet të komunikimit kombëtar. Dhe atëherë, kurrsesi nuk mund të thuhet se të folmet krahinore – të gjitha bashkë, me veçantitë e tyre dallimtare i kundërvihen njëra-tjetrës, se formojnë sisteme të veçanta, të vetme, se janë gjuhë. Nuk formojnë sisteme të veçanta, të vetme.

Norma gjuhësore. Siç dihet, gjuha letrare krijohet nga populli, siç është krijuar gjuha në tërësi. Asgjë nuk mund të kuptohet nga historia e gjuhës letrare shqipe nëse nuk vlerësohet historia e ligjëritimit popullor në të gjitha format e llojet, nëse nuk vlerësohet baza e saj popullore, domethënë, nëse nuk vlerësohen të gjitha mjetet gjuhësore, të cilat i ka gjuha e përgjithshme

¹ Metagjuha është, sigurisht më e gjerë se thjesht, terminolekti. Ajo është edhe i tërë leksiku special i një teksti.

² “Baza popullore i lidh në një të tërë të pandashme edhe të gjitha të folmet e sotme të shqipes dhe bën të mundshëm komunikimin në mes shqiptarëve kudo që janë, jo vetëm nëpërmjet gjuhës letrare të njësuar, por edhe në nivelin e gjuhës së folur”. A. Kostallari, “Baza popullore e gjuhës dhe i ashtuquajturit purizëm”, në *Studime filologjike*, 1990, 2, f. 6.

popullore në çdo etapë të zhvillimit të saj. Dhe kur flasim për bazën popullore të shqipes, kemi parasysh arritjet më të larta të kulturës gjuhësore shumëshekullore.

Nga këto arritje të larta të kulturës gjuhësore shumëshekullore vjen norma e sotme gjuhësore. Norma gjuhësore është tërësia e rregullave, që përcaktojnë përdorimin e mjeteve të gjuhës standarde njëlloj për të gjithë pjesëtarët e një kombi; (janë) mjetet gjuhësore që janë ngulitur e janë pranuar prej tyre. (*Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 698). Siç shihet edhe nga shpjegimi, norma ka rol ruajtës, konservativ. Ajo nuk mund të ndryshojë shpejt. Po të ndryshonte shpejt, do të prishej vijimësia midis gjuhës krahasimisht (relativisht) të së shkuarës jo të largët dhe gjuhës së sotme. Rregullsia ka, pra edhe karakter diakronik. Rol ruajtës, konservativ ka, sidomos gjuha e shkrimit. Bashkë me risitë rregullimtare, në këtë vetëzhvillim, tek ajo mbetet diçka prapa. Dhe kësajsoj, norma gjuhësore e gjuhës standarde lejon *ndonjë* luhajtje (le të themi, foljet më *-is: përsëris → përsërit*), por nuk krijohet truall për variante.³

Shënimi metagjuhësor **bised**. Në Fjalorët tanë ky shënim është për konceptin «ligjërim bisedor» (= në biseda të lira). A sjell ky shënim kufizim nga pikëpamja psikolinguistike e sociolinguistike? Me gjasë, a na thuhet se nuk është i pëlqyeshëm ligjërimi bisedor? Njëherësh, a bëjmë, ndoshta gabim sepse ne nuk kemi të drejtë të vendosim për të ardhmen e aksh njësie leksikore? Kur e etiketojmë aksh fjalë si bisedore, e kemi përcaktuar këtë të ardhme (= *është e kufizuar*). A kemi të drejtë? Dhe, si e ditkemi ne këtë të ardhme?

Një si shpjegim:

a) Fakti që ligjërimi bisedor u “kundërvihet” të gjitha stileve të tjera funksionale të gjuhës, tregon se ai ekziston në këtë a në atë shkallë edhe tek ato (p.sh., te ligjërimi publicistik).

b) Në të vërtetë, ligjërimi bisedor është (ligjërim) pa kufizime sociale. Pse? Sepse ai përdoret në ato mjedise kur njeriu dëshiron të jetë vetvetja.

c) Zakonisht, në gjuhën letrare ka dy lloje opozicionesh: 1) gjuhë e shkruar; 2) gjuhë (= ligjërim) bisedore. Mirëpo në këtë mes, është gjuha e letërsisë artistike, e cila u “kundërvihet” në tërësi të dyjave. Si, në ç’mënyrë: Ligjërimi bisedor është te pjesa estetike e gjuhës = te gjuha e letërsisë artistike, te gjuha e personazhit; por, edhe te gjuha e shkrimtarit. Edhe në fjalor, ky shënim është subjektiv. Ç’vend e sa vend i duhet lënë, është çështje konceptualizmi gjuhësor – leksikologjik e leksikografik. Dhe, kjo çështje ka të bëjë jo me fjalë të veçanta, por me klasa fjalësh (e formimesh), me fusha të caktuara leksiko-semantike, me grupe të caktuara tematike fjalësh etj.

Thëniet. Thënia është bashkëlidhje e rregullt, sendore-logjike, tipike e fjalëve të gjuhës. Në metagjuhën tonë është “tog dy a tri fjalësh që shërben për të sqaruar më mirë kuptimin e fjalës ose për të treguar përdorimin e saj” (*Fjalor*

³ Kurse në të folme ka amplitudë të gjerë luhajtjesh dhe krijohet truall për variante.

i gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f. 1124) Në leksikografi ka sinteza semantike. Këto sinteza bëhen edhe sipas konceptit “funksion gjuhësor”. Ky funksion gjuhësor realizohet sipas parimit të “gramatikës funksionale”. Kjo gramatikë vjen me mjete leksikore e gramatikore. Ku? Në thënie. Si e shpërfaqim këtë “gramatikë funksionale” në fjalorë?⁴

Jo rrallë, kemi vënë re që ka dualizma. Dualizmat (tipi *me karakter dialektor apo krahinor; krahinorizma a huazime krahinore; shprehje frazeologjike ose shprehje popullore* etj.) nuk na çojnë tek termi i duhur. As te koncepti shkencor. Sepse kriteri për zgjedhjen e përdorimit e termave për këtë a për atë koncept është të mos jenë ambigjenë, ekuivokë, të dykuptimshëm. Shembujt e mësipërm janë ekuivokë. Pyetja jonë është: A ka dualizma në përmbajtjen konceptore e terminologjike të termave **njësi leksikore / lemë / leksemë**? A janë sinonime? Si duhen vlerësuar?

Problemi i parë në këtë rast është mbingarkesa terminologjike. *Njësi leksikore* ose *leksemë*, ose *lemë* është një fjalë që del si zë më vete në një fjalor.⁵ Por në këtë kuptim leksikografët përdorin termin *fjalë*. Dhe, koncepti *njësi leksikore* (= fjalë) del i përgjithshëm e themelor. Atëherë, duhet të jetë më i përdorshmi dhe joekuivok. Por, po të vërehet praktika leksikografike, na duket se *fjalë* përdoret vetëm për kuptimin *leksemë*. Atëherë, nga pikëpamja praktike, mbase do të ishte më e përshtatshme të përdorej një fjalë → *leksemë* sesa një togfjalësh → *njësi leksikore*. Dhe, nëse *leksemë* nuk sjell ambigjeni, dykuptimësi, të pranohet. Nëse sjell, pse të mos krijojmë një term të ri – *leksizëm* (si *frazeologjizëm*)⁶, i cili, edhe pse i padëgjuar, nuk është ekuivok? Kriteri për zgjedhjen e termave për një koncept (po e përsërisim) është të mos jenë ekuivokë. Atëherë, duhen hequr ata që janë ekuivokë? Atëherë, mos *lema* na del edhe si *polisemë* (ngaqë është një lloj glose, por jo të gjitha glosat janë lema)? *Fjalë titull*? A mos është edhe kjo polisemë?

Kemi pranuar termin *leksemë*. Fjalët *lopë, dem, mëzat, viç* janë leksema në një fjalor. Por meqë fusha leksikore u përket niveleve të ndryshme, edhe leksemat mund të kenë nivele të ndryshme. Për shembull, për leksemat e mësipërme ka një nivel më të epërm. Është leksema *gjedh*. Por, në rendin e saj, fjala *kafshë* është në një nivel edhe më të epërm se *gjedh*. Atëherë, *kafshë* dhe *gjedh* janë *kryeleksema*; njëherësh – edhe leksema (në rendin e tyre). Në marrëdhënie gramatikore e leksikore, këto leksema janë analoge me njëra-tjetrën. Kryejnë funksione të njëjta gramatikore dhe hyjnë në një mjedis gramatikor e leksikor analog. Ato i bashkon edhe tipari i përgjithshëm semantik – të qenët *gjedh* / të qenët *kafshë*. Një tipar tjetër i përgjithshëm është të qenët

⁴ Shih, p.sh., te sy veprimin me foljet kalimtare *lëviz, hap, mbyll, kapsallit sytë* ose *i luaj / i shkel syrin diku*. Ky kontekstualizim na çon tek aktualizimi i fjalës.

⁵ Në metagjuhën tonë më të ngushtë është përdorur edhe togfjalëshi *fjalë titull*.

⁶ *Frazeologjizëm* = njësi frazeologjike.

frymor. Atëherë, ato formojnë edhe një klasë të caktuar fjalësh. Ky tipari i përgjithshëm semantik i bashkon ato në një klasë të caktuar. Shtjellimi mund të shkojë më tej, p.sh., te raporti klasë / fushë leksikore etj.⁷ Por, për temën tonë do të donim të bënim vetëm disa pyetje: Jo rrallë ndodhemi para një termi të ri në një fushë të dijes. Koncepti na vjen me përkufizimin shkencor. Dhe ne përpiqemi si ta emërtojmë konceptin. Ne e njohim konceptim *klasë leksikore*. E identifikojmë atë me përkufizimin. Ne njohim edhe atë tiparin e përgjithshëm që përcakton klasën. Atëherë, a mundet që këtë tipar ta identifikojmë e ta emërtojmë me *klasëmë*? (Edhe për analogji formimesh të tjera / tipi *leksemë* etj.).⁸ A është i pranueshëm? A e jep të saktë konceptin? A nuk ka dykuptimësi (ambigjeni)? A është bashkëkohor? A ndihmon për ta përplotësuar terminolektin tonë leksikor?

⁷ Klasema mund të karakterizojë fusha të ndryshme leksikore.

⁸ Edhe klasat kanë nivele. Krahaso: klasa *njeri* hyn te klasa *frymor*.